

### Dobësimi i Tregtisë Botërore në Shërbime si pasojë e goditjeve në ekonominë globale nga COVID-19

Sektori i shërbimeve po shndërrohet në sektorin bosht të ekonomisë globale dhe vlera e shtuar e tij në tregtinë botërore llogaritet në 50 % të saj. Sipas statistikave të Organizatës Botërore të Tregtisë, Mars 2020, në tregtinë e shërbimeve, norma e rritjes së tregtisë botërore në shërbime, ka perjetuar rënie në 3 – mujin e parë të vitit 2020.

Kjo normë qëndron nën nivelin bazë të indeksit, në masën 96.8 pikë, nga 98.4 pikë në muajin shtator 2019. Indikatorit ende nuk përfshin ndikimin e plotë të situatës prej COVID-19, dhe si rrjedhim pritet të bjerë akoma edhe më shumë në muajt në vijim.

Nëse shqyrtojmë në përbërje Indeks, rënien më të lartë e ka pësuar sektori i shërbimeve në transportin ajror të pasagjerëve (93.5) dhe transporti me kontenerët detarë (94.3). Rënia në indeksin e transportit detar kryesisht ka

qenë e ndikuar nga volumet e ulta të transportit detar në Azi, gjatë kësaj periudhe, ndërsa tkurrja e indeksit të shërbimeve në transportin ajror shtrihet gjeografikisht më gjerë, si pasojë e volumeve të ulta në kontinentin Amerikan dhe në Europë. Indeksi i shërbimeve në sektorin financiar shënon masën 97.7 dhe në shërbimet ICT në masën 97.0, duke shfaqur një trend rënës, ndërsa indeksi i ndërtimit shfaqet në nivele të qëndrueshme.

Komponenti i shërbimeve globale PMI, shënon masën 96.1, duke reflektuar qartë prirjet që COVID-19 do të vazhdojë të peshojë në tregtinë e shërbimeve në periudhën afatshkurtër. Në ndryshim nga tregtia e mallrave, fluktuacionet në tregtinë e shërbimeve matur nga ky indikator, përkohë me fluktuacionet në flukset aktuale tregtare, duke sinjalizuar për nevojat për riperstatje dhe ndryshime në modelin e tregtisë botërore të shërbimeve.

1 Niveli bazë është 100. Nëse vlerat janë mbi 100, indikatorit shënon rritje krahasuar me trendin afatmesëm, nëse janë nën 100, trendi është në rënie.

## DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



### Coronvirusi infekton sistemin ekonomik

**Nga Ardian Lekaj**

Natyrisht që pas krizës financiare të viteve 2008-2010 Bankat Botërore dhe Qeveritë kanë më pak rezerva për të përballuar krizën e re, ndaj dhe teori të vjetra ekonomike nxirren nga raftet dhe përdoren në treg. E tillë është teoria "helicopter money" të cilën e prezantoi për herë të parë ekonomisti Milton Friedman në vitin 1969. Ai u përpoq të shpjegonte efektin në ekonomi të pareve që "bien nga qielli". Kjo teori u rizgjua në fillim të viteve 2000 nga Ben Bernake, ish Guvernatori i Rezervave Federale, i cili pretendonte se në një mënyrë të tillë të hedhjes së parave në treg do t'i pengohej deflacioni. Këtë iniciative e zbatuan kohët e fundit edhe shtete si Hong Kong, Macau apo Singapori.

Për çdo qytetar mbi 18 vjeç dhe rezident në Hong Kong qeveria dha 1200\$. Kjo nuk është gjë tjetër veçse një metodë apo skemë monetare e qeverisë për rishërndarjen e të ardhurave pa asnjë implikacion monetar, rezultatet konkrete të së cilës ndoshta nuk do të dalin kurrë në pah.

### A mund të parashikohet apo parandalohet kjo situatë në të cilën ndodhemi sot?

Po të kishte një komunikim më transparent Botëror, sigurisht që efektet do të kishin qenë më të kontrollueshme. Po si në shumë raste epidemish kjo gjë u nënvleftësua dhe bile u fsheh informacioni i situatës fillestare në Kinë. Falë sistemit njëpartiak Kinez, ata arritën që qytete dhe fshatra t'i fusin në izolim total dhe të ngrënë spitale imediate të ndihmës së shpejtë brenda javës. Kuptohet se pas një reagimi të tillë vendin e zë ankthi dhe paniku për të nesërmen.

Mendoj se sot jemi në një luftë ekonomike. Kjo situatë ishte e pashmangshme për ekonominë botërore. Diçka e këtij apo atij lloji do të ndodhte, pasi ekonomia nuk mund të vazhdonte në të njëjtën mënyrë. Paraja sot nuk ka asnjë vlerë, bile dhe interesi bankar në Europë është negativ. Zhvillimi teknologjik i përbushi kërkesat minimale të konsumatorëve dhe kërkesa kaloi në luks. Kjo krizë padyshim do të jetë më e forta pasi ka kapur edhe sektorin e shërbimeve, gjë që nuk është parë më parë.

Shkrimin e plotë nga Ardian Lekaj mund ta lexoni këtu: <https://www.adbc.al/coronvirusi-infekton-sistemin-ekonomik/>



Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë kanë depozituar kërkesën e tyre për masa lehtësuese

[> Link <](#)



Forumi Ekonomik Mbarë-Shqiptar i propozon qeverive disa masa mbi situatën e krijuar pas Coronavirusit

[> Link <](#)

## Java në lajme



Bankat shtojnë sensibilizimin për Online Banking

[> Link <](#)



(Video) Situata e investimeve të huaja në Shqipëri!

[> Link <](#)

## Dy vendime



Në vijim të njoftimeve të mëparshme, në datë 17 mars 2020, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Gent Sejko dhe Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z Edi Rama kanë firmosur një urdhër të përbashkët për shtyrjen e afatit të pagimit të kësteve të kredisë për biznese dhe individë, të cilët do të hasin vështirësi në këtë periudhë si pasojë e COVID-19.

Më shumë mund të lexoni këtu:

[https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet\\_per\\_shtyp/Mbi\\_urdhri\\_n\\_e\\_Bankes\\_se\\_Shqiperise\\_dhe\\_Kryeministrise\\_per\\_shtyrjen\\_e\\_afatit\\_te\\_pagimit\\_te\\_kesteve\\_te\\_kredise\\_per\\_biznese\\_dhe\\_individe.html](https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet_per_shtyp/Mbi_urdhri_n_e_Bankes_se_Shqiperise_dhe_Kryeministrise_per_shtyrjen_e_afatit_te_pagimit_te_kesteve_te_kredise_per_biznese_dhe_individe.html)


Vendimi i qeverisë për pezullimin e mësimit në institucionet arsimore, masat për shmangien e grumbullimeve të njerëzve, rekomandimet për të punuar nga shtëpia, ndërprerja e një sërë aktivitetesh tregtare, masat e shtuara të kujdesit që duhet të aplikohen masivisht, etj., padyshim që do të ndikojnë në vëllimin e aktivitetit të bizneseve dhe gjenerimin e të ardhurave në nivele më të ulëta se parashikimet.

Për këto arsye, në mbledhjen e datës 12 mars 2020, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi shtimin e një dispozite të përkohshme në rregulloret e administrimit të rrezikut të kredisë për bankat dhe të administrimit të rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka dhe të shoqërive të kursim-kreditit, e cila synon t'u krijojë lehtësi këtyre subjekteve, që në rastet e paaftësisë paguese e kredimarrëseve gjatë periudhës tremujore, këto institucione të mos jenë subjekt i zbatimit të kërkesave të këtyre rregulloreve që lidhen me klasifikimin dhe krijimin e fondeve për provigjone.

Më shumë mund të lexoni këtu:

[https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet\\_per\\_shtyp/Masat\\_e\\_marra nga\\_Banka\\_e\\_Shqiperise\\_per\\_riskedulimin\\_e\\_kesteve\\_te\\_kredise.html](https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet_per_shtyp/Masat_e_marra nga_Banka_e_Shqiperise_per_riskedulimin_e_kesteve_te_kredise.html)

## Kursi zyrtar i këmbimit



Dollar Amerikan	USD	113.37	+1.82
Euro	EUR	123.03	+0.14
Poundi Britanik	GBP	130.51	-3.39
Franga Zvicereane	CHF	116.15	-0.36
Jeni Japonez (100)	JPY	103.78	-0.34
Dollari Australian	AUD	64.79	-1.53
Dollari Kanadez	CAD	78.05	+0.18

### Rreth Dhomës së Biznesit për Diasporën Shqiptare

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare është organizata e parë në shërbim të bizneseve të Diasporës. Si një organizatë e pavarur jo-fitimprurëse, ne jemi të përkushtuar të ndihmojmë dhe të nxisim bizneset e të gjitha madhësive për të maksimizuar potencialin e tyre në Shqipëri. Dhoma e Biznesit të Diasporës është një mundësi reale për mbështetjen e investitorëve të Diasporës që dëshirojnë të krijojnë apo të zgjerojnë biznese të tyre në atdhe.



Numrin e radhës të revistës Monitor mund ta lexoni këtu : [www.monitor.al](http://www.monitor.al)



Gazetën Çelësi mund ta lexoni këtu: <http://www.yellowpagesalbania.com>

